



*Agjencia e Kosovës për Akreditim
Agencija Kosova za Akreditaciju
Kosovo Accreditation Agency*



PLANI PËR INTEGRITET

I AGJENCISË SË KOSOVËS PËR AKREDITIM

2025-2027





DEKLARATA E INTEGRITETIT

Integriteti është themel i çdo sistemi të mirëqeverisjes, si dhe një nga parimet themelore të sjelljes në institucionet shtetërore, krahas besueshmërisë, ndershmërisë, transparencës, objektivitetit dhe bashkëpunimit.

Plani i integritetit është një dokument i brendshëm i Agjencisë së Kosovës për Akreditim (AKA) që përmban një sërë masash që parandalojnë dhe eliminojnë mundësitë për shfaqjen dhe zhvillimin e formave të ndryshme të korrupsionit, konfliktit të interesit dhe komunikimit përgjatë realizimit të proceseve që zhvillohen në AKA.

Qëllimi i Planit të integritetit është krijimi i mekanizmave që do të sigurojnë funksionimin efikas dhe efektiv të AKA-së përmes:

- Përforcimit të përgjegjësisë,
- Thjeshtimit të procedurave,
- Rritjes së transparencës në vendimmarrje,
- Kontrollit të autorizimeve diskrecionale,
- Respektimit të vlerave etike,
- Eliminimit të praktikave joefikase dhe rregulloreve të pazbatueshme,
- Implementimit të një sistemi efektiv të mbikëqyrjes dhe kontrollit të punës dhe sjelljes së punonjësve.

Ky Plan Integriteti përfshin risqet e integritetit sipas fushave funksionale të Agjencisë së Kosovës për Akreditim dhe aktivitetet konkrete për adresimin e tyre. Qëllimi i tij është përmirësimi i politikave, rregullave, praktikave të parandalimit të korrupsionit, si dhe forcimi i rezistencës institucionale ndaj shkeljeve të integritetit.

Dokumenti reflekton qasjen se si mund të kuptohet, zhvillohet dhe jetësohet ndërtimi i integritetit në strukturat e AKA-se por edhe përcakton mënyra dhe mekanizma efektive për një gjë të tillë.

AKA ka ndërmarrë hapa të rëndësishëm në përmirësimin e kornizës rregullatore dhe operacionale të integritetit. Hapi i miratimit të këtij Planit Integriteti, është pikërisht një përpjekje për të hedhur themelet e një sistemi më të gjerë, i cili menaxhon risqet që kërcënojnë integritetin institucional.

Synimet tona, të shprehura në këtë dokument, lidhen me krijimin e një mjedisi që nxit dhe promovon kulturën e integritetit, nëpërmjet një sistemi funksional të menaxhimit në Agjencinë e Kosovës për Akreditim.

DREJTOR I PËRGJITHSHEM – AGJENCIA E KOSOVES PËR AKREDITIM

NAIM GASHI

PËRMBAJTJE

HYRJE	4
METODOLOGJIA	5
PLANI DHE PËRMBAJTJA E PLANIT TË INTEGRITETIT	6
OBJEKTIVAT E PLANIT TË INTEGRITETIT	7
▪ Qëllimet e Planit të Integritetit	7
▪ Procesi i zhvillimit të planit të Integritetit;.....	8
METODA E VLERËSIMIT TË RREZIKUT.....	9
Monitorimi i zbatimit të Planit të Integritetit dhe raportimi.....	10
FUSHAT E RREZIKUT	10
▪ <i>Fushat e përgjithshme të rrezikut shembull janë:.....</i>	10
▪ <i>Fushat specifike të rrezikut janë:.....</i>	11
TABELAT.....	12-106

HYRJE

Në bazë të Nenit 25 të Ligjit nr. 08/L-017 për Agjencinë për Parandalimin e Korrupsionit/APK, si dhe udhëzueseve për përpilimin dhe zbatimin e planeve të integritetit, të përcaktuara me Metodologjinë për Planet e Integritetit, të gjitha institucionet janë të obliguara të hartojnë dhe miratojnë planet e integritetit. Andaj bazuar në obligimet ligjore dhe dokumentet e lartcekura edhe AKA ka hartuar Planin e Integritetit Institucional për vitet 2025-2027. AKA është institucion i pavarur, përgjegjës për sigurimin e brendshëm dhe të jashtëm të cilësisë, përfshirë akreditimin, riakreditimin, monitorimin, validimin dhe të gjitha proceset e tjera të sigurimit të cilësisë në institucionet e arsimit të lartë dhe programet e tyre të studimit në Republikën e Kosovës, sipas praktikave më të mira ndërkombëtare, përfshirë në veçanti standardet përkatëse evropiane në fushën e sigurimit të cilësisë në arsimin e lartë. Plani i integritetit është dokument strategjik dhe operativ, i cili mbështetet në gjetjen e provave dhe në rezultatet e procesit sistematik të vlerësimit të rrezikut të integritetit, të ndërmarrë brenda organizatës. Plani bazohet në identifikimin konkret të rreziqeve, analizën dhe vlerësimin e nivelit të rrezikut, prioritetet për ndërhyrje dhe specifikon masat sipas rreziqeve për arritjen e objektivave.

Qëllimi kryesor i Planit të Integritetit është ngritja e vetëdijes individuale dhe institucionale si mënyra për parandalimin e fenomeneve që mund të jenë të pranishme. Plani i Integritetit shërben edhe si mjet preventiv strategjik për të fuqizuar integritetin e institucionit, ku përfshihet integriteti individual, profesionalizmi, etika si dhe zbatimi i vlerave morale dhe standardeve profesionale.

Duke marrë parasysh qëndrueshmërinë dhe pasojat afatgjate të veprimeve, synojmë të rrisim integritetin në AKA.

METODOLOGJIA

Agjencia e Kosovës për Akreditim, duke u bazuar në obligimet përkatëse ligjore që derivojnë nga Ligji Nr. 08/L-017 për Agjencinë për Parandalimin e Korrupsionit, dhe duke u bazuar në Metodologjinë për Planet e Integritetit, brenda afatit të paraparë ligjore ka ndërmarrë veprime konkrete në iniciimin e përgatitjes së Planit të Integritetit të Agjencisë së Kosovës për Akreditim me veprimet si në vijim:

Vendimi Nr. 26/2023 i datës 28.08.2023 për Caktimin e Zyrtarit Përgjegjës për menaxhimin e përgatitjes dhe zbatimit të Planit të Integritetit të Agjencisë së Kosovës për Akreditim;

Vendimi Nr.1859/24 i datës 23.09.2024 për Themelimin e Grupit Punues për hartimin e Planit të Integritetit të Agjencisë së Kosovës për Akreditim;

Takimi i parë i Grupit Punues është realizuar në datë 09.12.2024;

Takimi i dytë i Grupit Punues është realizuar në datë: 28.05.2025;

Në përmbushje të obligimeve për përgatitjen e planit të integritetit, Grupi Punues me datë 20.01.2025 ka përgatitur pyetësoin, i cili është shpërndarë te punonjësit e agjencisë, (në formë elektronike dhe anonime) dhe i njëjti ka shërbyer për të marrë informacione të drejtpërdrejta nga të gjithë zyrtarët e Agjencisë, varësisht nga fusha të cilat i mbulojnë në kuadër të detyrave dhe përgjegjësi ligjor;

Zyrtarit Përgjegjës për menaxhimin e përgatitjes dhe zbatimit të Planit të Integritetit ka marrë pjesë në punëtorinë e organizuar nga Agjencia e Kosovës për Akreditim, me temën "Hartimi i Planeve të Integritetit" e cila është mbajtur me datë 20.10.2023;

Kryesuesi i Grupit Punues për përgatitjen e Planit të Integritetit ka dorëzuar draftin e parë të Planit të Integritetit te Drejtori i Përgjithshëm i AKA-së më 13 dhjetor 2024.

PLANI DHE PËRMBAJTJA E PLANIT TË INTEGRITETIT

Plani i Integritetit i AKA-së, krahas fushëveprimit dhe mandatit të përcaktuar ligjor, përmban vlerësimin e riskut të integritetit të Agjencisë të fokusuar në fusha konkrete që ndërlidhen me veprimtarinë dhe mandatin ligjor të institucionit. Me theks të veçantë, në pajtim me dispozitat përkatëse të Metodologjisë së Integritetit, përmban elementet si në vijim:

- Një vetëvlerësim të ekspozimit të institucionit ndaj korrupsionit dhe formave të tjera të shkeljes së integritetit;
- Informacion për fushëveprimin e institucionit dhe burimet njerëzore të angazhuara në institucion;
- Llojet e rreziqeve dhe format e tjera të shkeljes së integritetit;
- Masat ekzistuese të kontrollit;
- Masat parandaluese për zvogëlimin e rrezikut të korrupsionit dhe format e tjera të shkeljes së integritetit dhe afatet për zbatimin e tyre;
- Të dhëna të tjera, në përputhje me Metodologjinë për hartimin e planit të integritetit.

Përmes Planit të Integritetit synohet:

- Rritja e mundësive që institucioni të arrijë objektivat e menaxhimit të integritetit;
- Identifikimi dhe ndërmarrja e masave për minimizimin e mundësive për ekspozimin ndaj keqpëdorimeve dhe konflikteve potenciale të interesit;
- Mbajtjen e një sistemi për të siguruar pajtueshmërinë me kërkesat dhe standardet ligjore dhe procedurale;
- Rritjen e besimit të stafit dhe palëve të jashtme të interesit në përkushtimin për integritet që demonstron nga institucioni.

Bazuar në fushëveprimin dhe mandatin ligjor të Agjencisë së Kosovës për Akreditim, plani i integritetit në mënyrë të veçantë do të kontribuojë në vlerësimin dhe identifikimin e riskut në proceset:

- Menaxhimit të burimeve njerëzore;
- Financat dhe raportimi financiar;
- Çështjet ligjore;
- Vlerësimi dhe akreditimi;
- Monitorimi dhe
- Procedurat pasakredituese;

OBJEKTIVAT E PLANIT TË INTEGRITETIT

Agjencia e Kosovës për Akreditim, në kuadër të Planit të Integritetit, ka paraparë objektiva përkatëse, të cilët janë të harmonizuar plotësisht me mandatin ligjor të Agjencisë të parapara me ligjet përkatëse, si dhe me organizimin e brendshëm të institucionit.

Synimi i Agjencisë është që me implementimin e këtyre objektivave, të mundësohet ushtrimi i plotë i mandatit ligjor të Agjencisë.

Identifikimi i rreziqeve dhe ndërmarrja e masave për zvogëlimin e rreziqeve:

- Avancimi i proceseve për parandalimin e rreziqeve;
- Forcimi i etikës, imazhit dhe integritetit publik të AKA-së;
- Avancimi i transparencës dhe llogaridhënies së AKA-së;
- Avancimi i politikave për të promovuar integritetin dhe parandaluar keqpërdorimet në fushën e proceseve të akreditimit;
- Rritja e besimit të stafit dhe palëve të jashtme të interesit në përkushtimin për integritet që demonstrohet nga institucioni;
- Avancimi i vazhdueshëm profesional për zbatimin e projekteve dhe kontratave në përputhje me kornizën ligjore dhe rregullativën në fuqi.

Qëllimet e Planit të Integritetit

- Të zhvillohet një sistem efektiv dhe të qëndrueshëm për menaxhimin e integritetit të institucionit;
- Të përforcojë llogaridhënien dhe transparencën publike;
- Të rris rezistencën institucionale ndaj cenimeve të integritetit;
- Të planifikohen dhe zbatohen masat për menaxhimin e rrezikut të integritetit në institucion.

Procesi i zhvillimit të planit të Integritetit

Zhvillimi i Planit të Integritetit përbëhet nga disa faza, si në vijim:

- **Faza përgatitore:** Drejtori i institucionit merr vendim për emërimin e një Koordinatorit dhe Grupit Punues për hartimin e Planit të Integritetit. Ky grup pune përbëhet nga një numër i arsyeshëm anëtarësh, në varësi të kompleksitetit të institucionit ose numrit të punonjësve. Grupi punues bën mbledhjen e informacionit të nevojshme për zhvillimin e planit të integritetit si dhe njofton i të gjithë stafit për rëndësinë e Planit të Integritetit.
- **Faza e vlerësimit të rrezikut të integritetit** – gjatë kësaj faze koordinatori së bashku me grupin punues analizon dokumentacionin e mbledhur (legjislacionin dhe aktet nënligjore të zbatueshme në punën e Agjencisë së Kosovës për Akreditim; përshkrimet e vendit të punës dhe fushëveprimin, si dhe çdo proces për vendimmarrje dhe ofrimin e shërbimeve. Mbi bazën e analizës së gjendjes aktuale përcakton fushat e rrezikut dhe bën identifikimin dhe vlerësimin e rreziqeve.
- **Faza e përcaktimit të prioritetëve dhe propozimit të masave për përmirësimin e integritetit** – kjo fazë përfshin përcaktimin e prioritetëve për intervenimin, përcaktimi i masave për parandalimin/eliminimin e rreziqeve dhe përgjegjësitë për zbatim.
- **Faza e monitorimit dhe raportimit të planit të integritetit** - përfshin monitorimin, vëzhgimin dhe regjistrimin e rregullt të aktiviteteve që ndodhin në një Plan të Integritetit dhe procesin e mbledhjes së informacionit për të gjitha aspektet e zbatimit të Planit të Integritetit. Ndërsa, raportimi mundëson që informacionet e mbledhura të përdoren në marrjen e vendimeve që përmirësojnë zbatimin e objektivave të Planit të Integritetit. Në fund, Institucioni publikon planin e integritetit dhe miraton masat për përmirësimin e integritetit për periudhën tre (3) vjeçare.

METODA E VLERËSIMIT TË RREZIKUT

Metoda e vlerësimit të rreziqeve përcakton probabilitetin e shfaqjes dhe pasojave të cenimit të integritetit dhe formave të tjera të sjelljes së paligjshme ose jo etike.

Përmes vlerësimit të rrezikut përcaktohet mundësia e ndodhjes dhe niveli i pasojës, i cili mund të jetë: i ulët/i mesëm/i lartë. Niveli përfundimtar i rrezikut përcaktohet sipas matricës së rrezikut, në formën e një kombinimi mes mundësisë dhe pasojës.

Figura 1. Matrica e vlerësimit të rrezikut;

Pasoja /Ndikimi	Madhor	10									
		9									
		8									
	Mesatar	7									
		6									
		5									
		4									
	Vogël	3									
		2									
		1	2	3	4	5	6	7	8	9	10
Intenziteti i rrezikut (gjasat X ndikimi)		Ulët			Mesatar			Lartë			
		Probabiliteti/Gjasat									

Intenziteti i rrezikut fitohet duke shumëzuar probabilitetin/gjasën me pasojën/ndikimin, duke përdorur matricën e rrezikut, "ndikimi (1-10) x pasoja (1-10)", treguar në figurën si më lartë. Vlerësimi i përgjithshëm i rrezikut të korrupsionit dhe formave të tjera të cenimit të integritetit, vlerësohet nga 1 në 100, si në tabelën e më poshtme:

Ulët	Mesatar	Lartë
1 – 15 pikë	16 - 48	49 - 100

- Rreziku me intensitet të ulët – mundësia e ndodhjes së korrupsionit ose formave tjera të cenimit të integritetit është shumë e vogël për shkak të masave ekzistuese të kontrollit.
- Rreziku me intensitet të mesëm – ndodhja e korrupsionit ose formave tjera të cenimit të integritetit është e mundur, por masat e kontrollit menaxhojnë këtë rrezik.
- Rreziku me intensitet të lartë – korrupsioni ose format e tjera të cenimit të integritetit janë tashmë të pranishëm në këtë proces ose ka të ngjarë të ndodhin.

Vlerësimi i ndikimit të shfaqjes së rrezikut – Ndikimi është shumë i rëndësishëm për integritetin e institucionit.

Monitorimi i zbatimit të Planit të Integritetit dhe raportimi

Zbatimi i Planit të Integritetit do të monitorohet në vazhdimësi nga Zyrtari përgjegjës brenda institucionit dhe nga Agjencia për Parandalimin e Korrupsionit.

Monitorimi i vazhdueshëm i zbatimit është i rëndësishëm për t'u siguruar se kontrolli i rrezikut të integritetit dhe masat për trajtim janë efektive, si në hartim ashtu edhe në zbatim, dhe se procedurat janë kuptuar, si dhe plani integriteti është ndjekur.

Gjithashtu, monitorimi duhet të përcaktojë nëse masat e përdorura për trajtimin e rreziku kanë prodhuar efektet e planifikuara, kanë zbuluar ndryshimet në kontekstin e jashtëm dhe të brendshëm përfshirë ndryshimet e vetë rrezikut, ndryshime që kërkojnë rishikimin e trajtimit dhe prioritetëve të rrezikut si dhe kanë identifikuar cilat mësimë duhen nxjerrë për planifikim në të ardhmen.

Raportimi i rregullt siguron se zbatimi i Planit bëhet në përputhje me orarin dhe se rezultatet e planifikuara janë arritur. Gjithashtu, pas hartimit të raportit për zbatimin e planit të integritetit nga zyrtari përgjegjës brenda një institucioni, raporti duhet të dërgohet për vlerësim në Agjencinë për Parandalimin e Korrupsionit.

FUSHAT E RREZIKUT

✓ *Fushat e përgjithshme të rrezikut shembull janë:*

Duke u bazuar në të gjeturat e pyetësorëve dhe në analizën e gjendjes së përgjithshme, AKA ka identifikuar këto fusha të rrezikut:

- Menaxhimi i burimeve njerëzore;
- Financat dhe raportimi financiar;
- Çështjet ligjore;
- Vlerësimi, akreditimi dhe validimi;
- Monitorimi; dhe
- Procedurat pasakredituese.

Përveç fushave të përgjithshme, AKA ka identifikuar edhe fushën specifike të rrezikut.

✓ *Fushat specifike të rrezikut janë:*

- **Ndikimi politik dhe ndërhyrjet e jashtme;**
 - Emërimi i stafit ose anëtarëve të bordeve nga politika dhe jo përmes një procesi meritokratik.
 - Presione për të akredituar institucione ose programe që nuk përmbushin standardet minimale.
- **Konflikti i interesit;**
 - Ekspertë të përfshirë në vlerësim që kanë lidhje me institucionet që po vlerësojnë.
 - Raste kur vendimet merren për përfitime personale, biznesore ose funksionale.
- **Keqpërdorimi i detyrës zyrtare;**
 - Favorizim i institucioneve të caktuara për përfitime financiare ose personale.
 - Dhënia e paautorizuar e informatave dhe dokumenteve zyrtare për palët e treta.
- **Manipulimi i të dhënave;**
 - Pranimi i të dhënave të pavërteta, pa verifikim të mjaftueshëm konform rregullativës ligjore së AKA-së.
 - Ndërhyrje e paautorizuar në të dhënat e dorëzuar nga palët e jashtme.
- **Mungesa e transparencës;**
 - Mospublikimi i dokumenteve zyrtare.
 - Procedura jo të qarta për mënyrën se si merren vendimet për akreditim.
- **Dobësitë në kapacitetet profesionale;**
 - Mungesë e ekspertizës së mjaftueshme profesionale tek stafi apo vlerësuesit.
 - Trajnime të pamjaftueshme për vlerësuesit që mund të çojnë në gabime ose vendime të padrejta.
 - Mosnjohja e kontekstit lokal nga vlerësuesit e jashtëm.
- **Mungesa e etikës në vendimmarrje;**
 - Përdorimi i metodologjive të vlerësimit që nuk janë në përputhje me ESG standardet.
 - Vendime që nuk bazohen në prova ose analiza objektive.

Planit i Integritetit								
Fushat e përgjithshme të rrezikut								
Regjistrimi i rrezikut			Vlerësimi dhe matja e rrezikut			Veprimi ndaj rrezikut		
Fusha e rrezikut	Përshkrimi i Rrezikut	Masat ekzistuese të kontrollit	Gjasat	Ndikimi	Vlerësimi i rrezikut	Masat e propozuara për zvogëlimin / eliminimin e rreziqeve	Njësia/zyrtari përgjegjës	Afati i realizimit
Menaxhimi i burimeve njerëzore	Mungesa e mekanizmave efektivë për verifikimin e etikës, kompetencës dhe performancës së stafit.	Ligjet dhe aktet nënligjore të AKA-së. Të gjitha ligjet dhe aktet nënligjore, që afektojnë fushën e burimeve njerëzore të AKA-së.	2	4	8	Rekrutimi i stafit. Trajnimi i stafit. Vlerësimi i performancës së stafit. Raportimet e vazhdueshme.	Burimet njerëzore	Në vazhdimësi

Financat dhe raportimi financiar	Keqpërdorimi i fondeve publike, mungesa e transparencës në alokimin e burimeve financiare dhe raportimi financiar i pasaktë ose i manipuluar.	Ligjet dhe aktet nënligjore. Sistemi efektiv dhe funksional i menaxhimit të fondeve të AKA-së.	1	8	8	Trajnimi i stafit Vlerësimi i performancës së stafit. Raportimet periodike. Auditimi i pasqyrave financiare.	Udhëheqësi i divizionit për Buxhet dhe Financa	Në vazhdimësi
Çështjet ligjore;	Zbatimi jo i drejtë ose selektiv i legjislacionit për akreditim dhe mosrespektimi i procedurave ligjore të përcaktuara.	Ligjet dhe aktet nënligjore.	2	5	10	Trajnimi i stafit mbi ndryshimet ligjore eventuale. Vlerësimi i performancës së stafit. Raportimet e vazhdueshme.	Udhëheqësi i divizionit për çështje ligjore.	Në vazhdimësi
Vlerësimi dhe akreditimi	Proceset e vlerësimit nuk bazohen në standarde dhe praktikat profesionale.	Ligjet dhe aktet nënligjore.	2	6	12	Trajnimi i stafit. Vlerësimi i performancës së stafit. Raportimet e vazhdueshme.	Drejtori i Departamentit dhe udhëheqësi i Divizionit për Vlerësim dhe Akreditim.	12 muaj
Monitorimi dhe Procedurat Pasakredituese	Procesi i monitorimit të institucioneve të akredituara të jetë sipërfaqësor ose i ndikuar nga faktorë të jashtëm.	Ligjet dhe aktet nënligjore.	2	4	8	Trajnimi i stafit. Vlerësimi i performancës së stafit. Raportimet e vazhdueshme.	Departamenti për Monitorim dhe Procedura Pasakredituese.	12 muaj
Fushat e veçanta të rrezikut								

Regjistrimi i rrezikut			Vlerësimi dhe matja e rrezikut			Veprimi ndaj rrezikut		
Fusha e rrezikut	Përshkrimi i Rrezikut	Masat ekzistuese të kontrollit	Gjasat	Ndikimi	Vlerësimi i rrezikut	Masat e propozuara për zvogëlimin / eliminimin e rreziqeve	Njësia/zyrtari përgjegjës	Afati i realizimit
Ndikimi politik dhe ndërhyrjet e jashtme	Emërimi i stafit ose anëtarëve të bordeve nga politika dhe jo përmes një procesi meritokratik.	Ligjet dhe aktet nënligjore.	3	6	18	Ngritja e transparencës.	Qeveria dhe Kuvendi.	Sipas mandatit.
	Presione për të akredituar institucione ose programe që nuk përmbushin standardet minimale.		4	6	24	Publikimi i vendimeve të akreditimit.	KShC, KA dhe Drejtori i Përgjithshëm.	Në vazhdimësi
Konflikti i interesit	Ekspertë të përfshirë në vlerësim që kanë lidhje me institucionet që po vlerësojnë.	Ligjet dhe aktet nënligjore.	2	6	12	Nënshkrimi i deklaratës së konfidencialitetit.	KShC, KA dhe AKA.	Në vazhdimësi
	Raste kur vendimet merren për përfitime personale, biznesore ose funksionale.		2	7	14	Definimi i standardeve të AKA-së.	KShC, KA dhe AKA.	Në vazhdimësi
	Favorizim i institucioneve të caktuara për përfitime	Ligjet dhe aktet nënligjore.	2	7	14	Përditësimi i infrastrukturës ligjore.	AKA	12 muaj.

Keqpërdorimi i detyrës zyrtare;	financiare ose personale.							
	Dhënia e paaautorizuar e informatave dhe dokumenteve zyrtare për palët e treta.		2	5	10	Përditësimi i infrastrukturës ligjore.	AKA.	12 muaj.
Manipulimi i të dhënave	Pranimi i të dhënave të pavërteta, pa verifikim të mjaftueshëm konform rregullativës ligjore së AKA-së.	Ligjet dhe aktet nënligjore.	3	6	18	Trajnimi i stafit. Digjitalizimi i proceseve.	AKA.	12 muaj.
	Ndërhyrje e paaautorizuar në të dhënat e dorëzuar nga palët e jashtme.		3	6	18	Trajnimi i stafit. Digjitalizimi i proceseve	AKA.	12 muaj.
Mungesa e transparencës	Mospublikimi i dokumenteve zyrtare.	Ligjet dhe aktet nënligjore.	2	4	8	Zhvillimi i webfaqes së re Rritja e transparencës	AKA.	12 muaj.
	Procedura jo të qarta për mënyrën se si merren vendimet për akreditim.		2	4	8	Rritja e transparencës	AKA.	12 muaj.
Dobësitë në kapacitetet profesionale	Mungesë e ekspertizës së mjaftueshme profesionale tek stafi apo vlerësuesit.	Ligjet dhe aktet nënligjore.	2	4	8	Trajnim i stafit. Trajnimi i vlerësuesve të jashtëm.	AKA.	12 muaj.
	Trajnime të pamjaftueshme për vlerësuesit që mund të çojnë në gabime ose vendime të padrejta.		2	8	16	Trajnim i stafit. Trajnimi i vlerësuesve të jashtëm.	AKA.	12 muaj.

Mungesa e etikës në vendimmarrje;	Përdorimi i metodologjive të vlerësimit që nuk janë në përputhje me standardet ndërkombëtare.	Ligjet dhe aktet nënligjore.	2	3	6	Zhvillimi i standardeve mbi bazën e ESG.	KShC dhe AKA.	12 muaj
	Vendime që nuk bazohen në prova ose analiza objektive.		2	2	4	Definimi i standardeve të AKA-së.	KShC dhe AKA.	12 muaj.



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

Agjencia e Kosovës për Akreditim
Agencija Kosova za Akreditaciju
Kosovo Accreditation Agency



Ref.:634/25, Datë: 03.06.2025

Në mbështetje të nenit 6, paragrafi 1, nënparagrafi 1.11, neni 20, paragrafi 1, nënparagrafi 1.1 të Ligjit Nr. 08/L-110 për Agjencinë e Kosovës për Akreditim (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr. 13, 29 qershor 2023), nenit 23 dhe 25 të Ligjit Nr.06/L-113 për Organizimin dhe funksionimin e Administratës Shtetërore dhe të Agjencive të Pavarura, miratoi këtë:

V E N D I M

I. Miratohet Plani i Integritetit i Agjencisë së Kosovës për Akreditim.

II. Plani i Integritetit hyn në fuqi me nënshkrimin të këtij vendimi.

A R S Y E T I M

Bazuar në dispozitat ligjore të cekuar më lart Agjencia e Kosovës për Akreditim (tutje AKA) ka zbatuar procedurat ligjore për hartimin e Planit të Integritetit duke përfshirë edhe diskutimin publik me autoritetin përgjegjës për parandalimin dhe luftimin e korrupsionit – Agjencinë për Parandalimin e Korrupsionit. Në zbatim të Ligjit nr. 08/L-110 për Agjencinë e Kosovës për Akreditim (GZ.nr.13/29 qershor 2023, Prishtinë. Me qëllim të arritjes së objektivave strategjike zhvillimore të AKA-së, kryerjes së obligimeve ligjore që dalin ndaj AKA-së si agjenci rregullatore, si dhe referuar bazës ligjore të cekur më lartë Drejtori i Përgjithshëm vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Naim Gashi



Drejtor i Përgjithshëm

Agjencia e Kosovës për Akreditim

Vendimi iu dërgohet:

- Arkivit të AKA.